



Lajmëtari informativ i Qytetit të Shkupit

SHKUPË

| Numër 28 | Viti VI | 24 prill 2013 |

Numër
falas



**KONTEJNERË NËNTOKËSOR
PËR HERË TË PARË NË SHKUP**

Risi në mirëmbajtjen e higjienës komunale

DEPONONI MBETURINAT NË KONTEJNERËT NËNTOKËSOR



lëvizje hidraulike dhe është një nga më modernët në regjion. Ky operacion u mundësua me blerjen e automjeteve me të cilat e pajisëm NP „Higjiena komunale“. Realizimi i këtij projekti do të kontribuojë që të modernizohet pamja e kontejnerëve për deponimin e mbetjeve komunale, që të mënjanojnë kontejnerët mbetokësor metalik dhe të fshihet pamja me mbetje të hedhura rreth kontejnerëve. Dua të apeloj deri te qytetarët, t'i përdorin në mënyrë të ndërgjegjshme kontejnerët e rinj dhe të kontribuojnë ambient jetësor më të pastër – tha kryetari Koce Trajanovski.

Bartësi i Projektit për vendosjen e kontejnerëve nëntokësor është NP „Higjiena komunale“. Për realizimin e tij janë ndarë gjithsej 33 milion denarë, nga të cilët nga 10 milion denarë investuan Qyteti i Shkupit dhe komuna Qendër, kurse 13 milion denarë NP „Higjiena komunale“.



Qytetarët e Shkupit për herë të parë kanë mundësi mbetjet shtëpiake t'i deponojnë në kontejnerë nëntokësor. Ky projekt kontribuoi për modernizimin e sistemit të deponimit dhe ngritjes së mbetjeve komunale dhe përmirësimit të higjienës publike në qytet.

Ekipet e Qytetit të Shkupit këto ditë vendosën edhe 10-të platforma me kontejnerë nëntokësor, nga gjithsej 14, që do të vendosen në territorin e qendrës së qytetit. Në 5 lokacione do të vendosen nga 4 kontejnerë nga të cilët 3 do të shfrytëzohen

për përcjelljen e mbetjeve të përziera, kurse 1 për ambalazhin PET. Në lokacionet e tjera do të vendosen nga 3 kontejnerë, 2 për mbetjet e përziera dhe 1 për ambalazhin PET. Ekipet e Qytetit të Shkupit vendosën edhe dy platforma me nga dy kontejnerë, në dy lokacione në komunën e Çairit.

Kontejnerët janë nga firma ATRIK nga Republika e Sllovenisë dhe janë me kapacitet 3 metra kub.

- Sistemi që do të përdoret për nxjerrjen dhe lëshimin e kontejnerëve, përkatësisht zbrazen e tyre, punon me



Ndërmarrja publike „Higjiena komunale“ muajin e kaluar u rinovua me 10 automjete të reja të specializuara për grumbullimin e mbetjeve dhe 5 moto-kultivator. Kamionët e rinj për grumbullimin e mbetjeve mund të lëvizin në rrugicat më të vogla dhe më të ngushta, kurse moto-kultivatorët janë me pajisje të plota lidhëse, përkatësisht me lidhje për grumbullimin e borës në dimër, furça për fshirjen e trotuareve dhe korsive, si dhe freza dhe pajisje të tjera.

AUTOMJETE TË REJA PËR NP „HIGJIENA KOMUNALE“



reja dhe automjete për grumbullimin e mbetjeve dhe përmirësuam higjienën në qytet – theksoi kryetari Koce Trajanovski, në promovimin e automjeteve të reja.

Automjetet komunale speciale të blera janë me kapacitet plotësues prej 1,5 metra kub. Shasia e kamionëve është nga kompania kineze DSM, kurse pjesët plotësuese të firmës së njohur turke Yeni Balkan.

5 moto-kultivatorët e rinj të blerë janë nga marka e njohur GOLDONI me fuqi prej 12 kuaj fuqi dhe pajisje të plota lidhëse.

Për blerjen e 10-të kamionëve janë ndarë rreth 9 milion denarë, kurse për moto-kultivatorët rreth 2 milion denarë, mjete të cilat janë siguruar plotësisht nga Ndërmarrja publike „Higjiena komunale“.

- Me blerjen e këtyre pajisjeve mund të themi që plotësuam premtimin e dhënë para qytetarëve në vitin 2009. Ndërmarrjen publike „Higjiena komunale“ e rinovuam me pajisje plotësisht të

rreth 2 milion denarë, mjete të cilat janë siguruar plotësisht nga Ndërmarrja publike „Higjiena komunale“.





U nënshkrua kontrata për koncesion

DRISLLA DO TË SHNDËRROHET NË DEPO MODERNE

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski dhe Maksimiliano Feracoli, drejtues i konsorciumit pjesë përbërëse e FCL AMBIENTE SRL dhe UNIECO SCC COOP nga Italia, më 4 janar nënshkruan kontratë për investim të përbashkët në Ndërmarrjen publike Depo „Drislla“, me qëllim kryerjen e veprimtarisë koncesive. Kontrata për koncesion është me afat kohor prej 35 vjetësh dhe do të mundësojë që „Drislla“ të shndërrohet në një depo moderne për riciklimin e mbetjeve dhe shfrytëzimin e energjisë.

- Konsorciumi me të cilin sot u nënshkruajmë kontratë ofroi zgjidhjen më të mirë për depon „Drislla“. Investimi i përgjithshëm për transformimin e „Drislla“ do të jetë me vlerë 73 milion euro. Investimi i mjetëve është planifikuar në një periudhë nga 4 deri në 5 vjet në të cilën depoja do të shndërrohet në industri, në të cilën mbetjet do të transformohen në energji dhe repro-material, lëndë sekondare, gjë me të cilën do të zvogëlojë në mënyrë drastike sasinë e mbetjeve që do të përcillen në mënyrë të përhershme në depo dhe do të kenë shfrytëzim më të madh të pjesëve ripërtëritëse të sërishme. Me kënaqësi nënshkruam kontratën për koncesion me kohëzgjatje prej 35 vjetësh dhe shpresoj se Qyteti i Shkupit do të ketë një fabrikë moderne, në të cilën do të marrë pjesë me 20 për qind të investimit të përgjithshëm, do të marrë 20 për qind fitim, dhe do të deponojë sipas standardeve evropiane mbetjet – tha kryetari Trajanovski, në nënshkrimin e marrëveshjes.

FCL Ambiente MK SHMPKTHPV planifikon hapat e mëposhtëm në menaxhimin dhe deponimin e mbetjeve:

1) Realizimi dhe vendosja në funksion e fabrikës për paketimin e mbetjeve, me ndarje automatike të metaleve që përmbajnë, dhe metaleve që nuk përmbajnë hekur, integrimin e linjës për ndarje manuale me qëllim përdorimin e sërishëm të

seksioneve ripërtëritëse nëpërmjet riciklimit, i cili do të mundësojë zvogëlimin e volumit të mbetjeve që do të përcillen në depo dhe do të zvogëlojë krijimin e kullimit.

2) Masat fillestare për intervenime emergjente të depos dhe fillimin në të njëjtën kohë të studimeve për thellimin e hulumtimeve të depos, me qëllim finalizimin përfundimtar për fillimin e aktiviteteve për sigurinë e përcjelljes së mbetjeve të grumbulluara dhe ruajtjen e ambientit jetësor.

3) Fabrika automatike, për ndarjen, seleksionimin e mbetjeve komunale dhe mbetjeve të ngjashme me ato komunale, me shfrytëzimin e fraksioneve të ndara dhe prodhimit të RDF (RefuseDerivedFuel), me kapacitet mbi 250 000 ton në vit.

4) Fabrika e kompostimit të mbetjeve nga gjelbërimi dhe fabrika adekuate për prodhimin e kompostos me cilësi të lartë.

5) Fabrikë për trajtimin e mbetjeve inerte, ose mbetjeve që dalin nga operativa ndërtimore dhe rrënimet, me shfrytëzimin e sërishëm të fraksioneve ripërtëritëse.

6) Fabrika për trajtimin e mbetjeve industriale.

7) Intervenime për sigurimin e depos me kaptazhin e gazit biologjik, punë për pranimin dhe trajtimin e kullës.

- Fabrikat e ndërtuara do të kenë mundësi të riciklojnë mbi 70 për qind të mbetjeve hyrëse dhe të sigurojnë fleksibilitet maksimal, dhe që është akoma më e rëndësishme të zvogëlohet ndikimi mbi ambientin jetësor, kryesisht me përdorimin e energjisë së rigjeneruar nga fabrika e biogazit, të plotësuar me fabrikën fotovoltike - theksoi në fjalën e tij Domenico Feracoli, presidenti i FCL Ambiente.



PO NDËRTOHET RRJET I RI UJËSJELLËSI NË RRUGËN “VASKO KARANGJELEVSKI”



Ekipet e Qytetit të Shkupit vendosën 100 metra nga rrjeti i ri i ujësjellësit përgjatë rrugës “Vasko Karangjelevski”, i cili do të zgjidhë një nga problemet më të mëdha në këtë pjesë të Aerodromit të vjetër.

- Rrjeti i ri i ujësjellësit po ndërtohet nga kryqëzimi i rrugës “Vasko Karangelevski” me rrugën “Treta makedonska brigada” deri në kryqëzimin te poliklinika „Jane Sandanski” dhe do të jetë i gjatë 350 metra. Në këtë drejtim janë vendosur dy tubacione – i pari me profil 150 milimetra për zonën e lartë dhe i dyti me profil 300 milimetra për zonën e ulët. Tubat janë prej hekuri daktil. Ndërtimi i rrjetit të ri do të mundësojë furnizimin më me kualitet me ujë të pijshëm për ndërtesat banesore në Aerodromin e vjetër, si dhe për ndërtesat e reja përgjatë rrugës “Treta makedonska brigada” – thotë kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski.

Për këtë punë ndërtimore Qyteti i Shkupit do të ndajë rreth 7 milion denarë.

KANALIZIM ATMOSFERIK EDHE PËR RRUGËN “PERO NAKOV”

Ndërtimi i kanalizimit atmosferik në rrugën “Pero Nakov” dhe në rrugën 840BIS në komunën Gazi Baba përfundoi në afatin e parashikuar. Tubat dhe vend derdhjet për kanalizimin atmosferik janë tashmë të vendosura, trotualet përgjatë pjesës së gërmuar janë formuar, kurse këto ditë u rinovua edhe rruga automobilistike e dëmtuar në kryqëzimin me rrugën “Blagoja Stefkovski” me rrugën “Pero Nakov” dhe rrugën 840BIS.

Në këtë pjesë të rrugës “Pero Nakov” dhe në rrugën 840BIS gjatë kohës së shirave të rrëmbyeshëm grumbullohej ujë në rrugën automobilistike, dhe komunikacioni rrugor zhvillohej me vështirësi. E rëndësishme është që

edhe si pjesë e punës ndërtimore, Qyteti i Shkupit në këtë pjesë të rrugës automobilistike ndërtoi trotuare nëpër

të cilat qytetarët do të lëvizin në mënyrë të sigurt. Vlera e përgjithshme e projektit është rreth 2,8 milion denarë.





PO NDËRTOHET PLOTËSISHT KOLEKTORI FEKAL NË INXHIKOVË

Kolektor fekal me gjatësi 1 300 metra me profil 800 milimetra këto ditë po ndërtohet në Inxhikovë, lagjia Pitu Guli, si investim i përbashkët i Qytetit të Shkupit, komunës Gazi Baba dhe NP „Ujësllës dhe kanalizim“. Deri tani janë ndërtuar 410 metra nga rrjeti i ri fekal, kurse punët ndërtimore do të vazhdojnë kur do të përmirësohen kushtet atmosferike.

- Me ndërtimin e këtij kolektori do të zgjidhen problemet shumëvjeçare të banorëve të kësaj pjese të komunës Gazi Baba. Ndërtimi i kolektorit do të zgjidhë

përcjelljen e ujërave fekale nga lagjet Tumba dhe Pitu Guli, si dhe të një pjese të lagjeve Metodija Antov Çento dhe Kamnik, gjë me të cilën do të krijohen kushte që të nxirret jashtë përdorimit stacioni i pompimit në Maxhari dhe do të pengohet edhe rrjedhja e ujërave fekale. Me kontratën për ndërtimin e kolektorit fekal nga Inxhikova drejt stacionit të pompimit Maxhari, ndërmjet Qytetit të Shkupit, komunës Gazi Baba dhe Ministrisë për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe planifikimin e hapësirës, deri tani janë ndërtuar 260 metra, kurse tani dalëngadalë

përfundon ky projekt që është me rëndësi të jashtëzakonshme për qytetarët përreth. Dua t'i falënderoj qytetarët për durimin e treguar dhe bashkëpunimin në realizimin e këtij projekti – tha kryetari Koce Trajanovski.

Ndërtimi i rrjetit të ri fekal duhet të përfundojë deri në fund të vitit.



Më parë



Pastaj



U NDËRTUA URË E RE MBI LUMIN SERAVA

Ekipe e Qytetit të Shkupit ndërtuan një urë të re mbi lumin Serava, e cila lidh korsinë e patinave-biçikletave të anës së majtë të lumit Vardar në pjesën ku ishte ndërprerë.

- Qyteti i Shkupit përfundoi me sukses dhe në afatin e parashikuar ndërtimin e urës së re mbi lumin Serava, në derdhjen e lumit Vardar. Me ndërtimin e urës mbi lumin Serava qytetarëve të Shkupit iu mundësua lëvizje e pandërprerë nëpër korsinë e patinave-biçikletave, nga ura te hoteli „Aleksandar Palas“ deri në urën „Todor Aleksandrov“ (ura e mëparshme „Binjaku“), me gjatësi

rreth 8 kilometra. Ura e re është prej betoni të armuar, me gjatësi 16,6 metra dhe gjerësi 4,6 metra. Rruga automobilistike është e asfaltuar. Rrethimi mbrojtës i urës së re është përgatitur nga tuba çeliku, kurse ndriçimi është mundësuar me llambat që ndriçojnë korsinë e patinave-biçikletave nga ana e majtë e lumit Vardar. Qyteti i Shkupit për ndërtimin e kësaj ure ka shpenzuar rreth 4,8 milion denarë – theksoi kryetari Koce Trajanovski.

Pjerrësitë rreth krahëve prej betoni, nga të katër anët, janë ndërtuar me gurë. Ambianti rreth urës do të gjelbërohet.



NQP U PAJIS ME LAVAZH TË RI PËR AUTOBUSËT

NQP „Shkup“ lëshoi në përdorim lavazh të ri për autobusë i cili është rregulluar në sallën e rinovuar të kësaj ndërmarrjeje publike, në punktin Gjorçe Petrov.

- Lavazhi ka relativisht fuqi të madhe lëshimi, përkatësisht është me kapacitet larjeje të jashtme prej 25 autobusë për një orë. Me hapjen e këtij lavazhi u përmirësua higjiena e autobusëve, kurse qytetarëve të Shkupit iu mundësua jo vetëm të udhëtojnë me autobusë të rinj por edhe të pastër. Vendorsëm në përdorim edhe sallën e dytë të rinovuar në punktin e

ndërmarrjes publike në Gjorçe Petrov, kurse vitin e ardhshëm planifikojmë ta rinovojmë edhe sallën në Autokomandë, e cila gjithashtu do të pajiset me lavazh modern – sqaron kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski.

Në këtë rinovim të sallës së NQP-së në Gjorçe Petrov është vendosur aparat për larjen e jashtme të autobusëve EKOBUS C 4000, i cili përbëhet nga: rezervuari për ujin industrial, njësia për sjelljen e ujit të freskët, mbajtëse e furçave me dorë të zgjatur dhe njësinë elektrike. Gjithashtu, aparati i ri ka edhe sensor që gjatë larjes të mos mënjanojen



pasqyrat anësore.

Larja e autobusëve zhvillohet në disa faza, përkatësisht përdoren mjete-shampo për paralarje, larje dhe tharje të shpejtë të automjetit. Lavazhi është pajisur edhe me spërkatëse për larje të poshtme të autobusëve.

Për rikonstrukcionin e sallës së NQP-së Gjorçe Petrov e cila është pajisur me lavazh të ri Qyteti i Shkupit nga buxheti ndau 10 milion denarë.



3 LINJA TË REJA AUTOBUSI TË NQP-së

Me kërkesë të qytetarëve, NQP „Shkup“ vendosi tri linja të reja autobusi provë. Linja e re e autobusit me numër 33, do të qarkullojë në drejtimin nga Lisiçja e poshtme, nëpërmjet Lisiçes së sipërme, Qendrës transportuese, Jugodrvio dhe sheshit „Maqedonia“, deri në stacionin e fundit te Shtypshkronja.

- Linja e re autobusit me numër 5A do të qarkullojë në relacionin nga lagjia Deksion në komunën Gjorçe Petrov deri te Qendra klinike, përkatësisht nëpër trasenë – Deksion, rrugët „Gjorçe Petrov“, „Adolf Ciborovski“, bulevardin „Mitropolit Teodosij Gologanov“, rrugën „Qiril dhe Metodij“, bulevardin „Nënë Tereza“ (bulevardi i mëparshëm „Vodnjanska“) deri te Qendra klinike.

Me kërkesë të qytetarëve dhe të nxënësve të SHF „Koço Racin“ qarkullon edhe linjë provë, e cila akoma nuk ka numër, kurse do të qarkullojë në relacionin nga Shtypshkronja, nëpërmjet bulevardit „Nënë Tereza“, nëpër rrugët „Pitu Guli“, „Dimitar Pandilov“ dhe „Karaorman“.



Me lëshimin në përdorim të 79 autobusëve të rinj dykatësh, në fillim të vitit Ndërmarrja e qarkullimit publik „Shkup“ rinovoi plotësisht parkun e vet të automjeteve. Me përfundimin e projektit voluminoz për rinovimin e parkut të automjeteve të NQP-së në rrugët e qytetit tani qarkullojnë gjithsej 312 autobusë të rinj, nga të cilët 80 janë me dysheme të ulët nga kompania ukrainase „LAZ“, 215 janë autobusë dykatësh dhe 16 janë minibusë nga „Yutong“ nga Kina.

- Kjo është edhe një ditë tjetër e madhe për NQP-në, promovojmë 79 autobusë dykatësh, nga të cilët 64 janë për

transportin urban, kurse 15 për udhëtim panoramik. Projekti për rinovimin e parkut të automjeteve të NQP „Shkup“ është rezultat i

Trajanovski, në promovimin e autobusëve të rinj dykatësh.

Ministri i transportit dhe lidhjeve,



U RINOVUA PLOTËSISHT PARKU I AUTOMJETEVE TË NQP-së



bashkëpunimit të mirë të Qytetit të Shkupit me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Autobusët e rinj janë përgatitur sipas të gjitha teknologjive udhëheqëse dhe i plotësojnë të gjitha standardet e nevojshme, të pajisura me motorë ekologjik, takograf digjital, drejtim automatik të rampës për karrocet e invalidëve dhe të fëmijëve, janë të aklimatizuar dhe shumë më komod se autobusët që përdorehin më parë në transportin urban – tha kryetari Koce

Mile Janakievski, në fjalën e tij theksoi se me lëshimin në përdorim të autobusëve të rinj përfundon një projekt i suksesshëm për zëvendësimin e autobusëve të vjetër të cilët ndotnin ambientin jetësor me autobusë të rinj dhe modern.

Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Nikolla Gruevski, potencoi se ky është edhe një projekt i suksesshëm i Qeverisë për të cilin qeveria ndau nga buxheti 57 milion euro.

NQP „SHKUP“ – 65 VJET BASHKËUDHËTARI YNË BESNIK



Ndërmarrja e qarkullimit publik „Shkup“ më 17 janar kremtoi 65-vjetorin e themelimit të saj. Ndërmarrja është themeluar më 17.01.1948 dhe që atëherë zhvillohet me rritjen dhe zhvillimin e Shkupit. Sipas përlllogaritjeve, që nga formimi i vet e deri tani, autobusët e NQP-së kanë kaluar 800 milion kilometra dhe kanë transportuar 5,5 miliardë udhëtarë.

- Falë përkushtimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Qyteti i Shkupit mori 312 autobusë të rinj për transportin publik të udhëtarëve, me dysheme të ulët dhe dykatësh. Me këtë u rinovua parku i automjeteve të ndërmarrjes publike, kurse qytetarët përfituan transport publik ekologjik, të sigurt dhe komod. Përveç rinovimit të parkut të automjeteve, Qyteti i Shkupit e ndihmon ndërmarrjen e qarkullimit publik në shumë mënyra. Përveç subvencioneve për çmimet e ulëta të biletave që në nivel vjetor janë me vlerë nga dy deri në tre milion euro, Qyteti i Shkupit investoi edhe në infrastrukturën e ndërmarrjes publike. Në fillim të vitit 2012,

rinovuan një sallë shërbimi në auto-bazën Gjorge Petrov, të cilën e pajisëm me sistem modern automatik për mirëmbajtjen e autobusëve. Investimi ishte me vlerë 10 milion denarë. Nga fundi i vitit 2012, lëshuam në përdorim edhe lavazhin e rinovuar për autobusë, gjë me të cilën u përmirësua në mënyrë drastike higjiena e autobusëve. Qytetarët më të moshuar fituan mundësinë për transport falas në autobusët e NQP-së, tri ditë në javë. Do të përmend edhe teleferikun e ri në Vodno, i cili është donacion nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, dhe me të cilin menaxhon me sukses NQP-ja. Përkrahja e Qytetit të Shkupit për NQP-në vazhdon. Nga buxheti i Qytetit të Shkupit, në tre vitet e ardhshme – në mënyrë zhvilluese, do të ndahen rreth 60 milion denarë për ndërtimin e 270 stacioneve të autobusëve, si dhe 180 milion

denarë për sistemin e lokacionit automatik të automjeteve dhe për pagimin automatik të biletave – tha kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, në kremtimin e jubileut.

Drejtori i NQP-së, Misho Nikollov, në fjalën e tij vuri theksin në fillimet e punës së ndërmarrjes së qarkullimit publik.


- Linja e parë e vendosur në Shkup është nga „Trosharina e Kumanovës“ (Autokomanda e sotme) nëpërmjet bregut të lumit Vardar deri në Parkun e qytetit, që në vitin 1955 në qytet funksionojnë 8 linja autobusi. Në vitin 1953 në Shkup për herë të parë vijnë autobusët dykatësh. Sot, NQP „Shkup“ është ndërmarrje publike moderne që zhvillohet nga dita në ditë. Disponojmë me autobusë të rinj, të pajisur në mënyrë më moderne dhe transportojmë rreth 50 milion udhëtarë – theksoi Nikollov.



TRANSPORT PUBLIK I PRIVILEGUAR PËR PERSONAT ME NEVOJA TË VEÇANTA


Qyteti i Shkupit siguroi 2 243 legjitimacione për transport publik të privilegjuar për personat me shikim të dëmtuar, persona me dëgjim të dëmtuar, persona me invaliditet trupor, persona me pengesa në intelekt, persona të sëmurë nga veshkat, si dhe invalid të punës, pensionistë invalid dhe invalidë të luftës, të organizuar në shoqata adekuate civile të Qytetit të Shkupit. Prej tyre 2 085 janë legjitimacione falas, kurse 158 – legjitimacione falas me shoqërim.

Qyteti i Shkupit realizoi në mënyrë të plotë Programin për shfrytëzimin e privilegjuar të transportit publik në territorin e Qytetit të Shkupit, për personat me nevoja të veçanta për vitin 2013, me qëllim që të ndihmohet në realizimin e përkujdesjes sociale të personave me nevoja të veçanta, përmirësimin e lëvizjes së tyre në bashkësinë urbane dhe përfshirjen lehtësuese të tyre në rrjedhat sociale dhe shoqërore. Mjetet e përgjithshme të nevojshme për realizimin e Programit janë me vlerë 31 218 504 denarë.



Deri në fund të vitit Ndërmarrja e qarkullimit publik „Shkup“ do të vendosë 226 stacione të reja autobusi, në shumë lokacione nëpër qytet.

- Stacionet e reja të autobusit, sipas kontratës, do të fillojnë në prill, dhe të gjitha duhet të vendosen deri në fund të vitit. Do të vendosen 3 tipa stacionesh të cilat dallohen për nga madhësia e tyre, dhe të njëjtët do të kenë strehë, tabelë informuese, stol për



KËTË VIT STACIONE TË REJA AUTOBUSI



qëndrim, kosh për mbeturina dhe tabelë me emrin e stacionit dhe numrat e autobusëve që qëndrojnë në të. Me këtë qytetarët do të kenë stacione autobusi të reja dhe moderne – sqaroi kryetari Koce Trajanovski, në promovimin e projektit.

Drejtori i NQP-së, Misho Nikollov, prezantoi pamjen e tabelave informuese që do të qëndrojnë në të gjitha stacionet e autobusit, që u zgjodh në një konkurs të veçantë të hapur. Gjatë kësaj, ai theksoi se gjendja me stacionet e autobusëve është një nga problemet më të shpeshta që para tyre paraqesin qytetarët dhe se me vendosjen e stacioneve të reja do të plotësohen tërësisht kërkesat e tyre.

Për blerjen e 226 stacioneve të reja janë ndarë rreth 66 milion denarë.



„SHKUP“

LAJMËTARI INFORMATIV I

QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ

„Shkupi“ u botua më:

10 dhjetor 2008

Kryeredaktor

Nedelço Krstevski

Redaksia

Seksioni për marrëdhënie me
opinionin

Redaktor i fotografi së

Radomir Jovanoviç

Përkthyes dhe lektor

Vladimir Bogdanovski dhe Behar Dalipi

OTON QYTETI I SHKUPIT

për botuesin

Kryetari i Qytetit

Koce Trajanovski

Bulevardi Ilindenska p.n.

Telefon

02 3297 255

e-mail adresa

gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni/Botol:

Graficki Centar Skopje

32 MILION EURO PËR RIKONSTRUKSIONIN E SHKOLLAVE TË MESME

Qyteti i Shkupit në buxhetin e tij do të ndajë rreth 32 milion euro për rikonstruksionin e 21 shkollave të mesme, që janë nën kompetencat e tij.

- Këto mjete me vlerë 18 milion denarë do të investohen në projekte të cilat përmirësojnë efikasitetin energjetik të shkollave, pikërisht do të kryhet



zëvendësimi i zdrukthëtarisë dhe rikonstruksioni i çatave të vjetra të objekteve shkollore. Mjetet e mbetura do të përdoren për rikonstruksionin e nyjave sanitare, zëvendësimi i instalimit të amortizuar elektrik dhe për rikonstruksionin e dysHEMEVE në shkolla dhe në sallat e fizikuturës. Nga këto mjete 5 milion denarë do të investohen në shkollën „Pançe Karagjov” ku gjatë pushimit veror do të kryhet zëvendësimi i plotë i çatisë— thotë kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski.

Vitin e kaluar për mbulimin e një pjese të godinës shkollore të SHMQSH „Pançe Karagjov” u shpenzuan 1,5 milion denarë. Gjatë kësaj pune është mbuluar me llamarinë një sipërfaqe prej 520 metra katror.


Këtë vit do të mbulohen dy lamelat ku janë rregulluar klasat.

SI SHPENZOHEN PARATË TUAJA


Raporti Vjetor Financiar i Qytetit të Shkupit 2012



	BUXHETI THEMELOR	Realizimi 31.12.2012
TË ARDHURA TË PËRGJITHSHME	4.058.500.000	2.634.396.287
Të ardhura tatimore	2.585.400.000	2.030.709.715
Të ardhura jo tatimore	116.100.000	173.858.283
Transferime	112.000.000	60.630.531
Të ardhura kapitale	1.245.000.000	369.197.759



	Buxheti	Realizimi 31.12.2012
SHPENZIME TË PËRGJITHSHME	4.058.500.000	2.626.587.508
I Investime kapitale	2.285.758.000	1.176.254.105
II Mirëmbajtja e objekteve komunale dhe infrastruktura	965.300.000	864.558.871
III Shpenzime për administratën dhe Këshillin e Qytetit të Shkupit	488.347.000	336.197.915
IV Realizimi i kompetencave me interes publike	319.095.000	249.576.619



	Realizuar përfundimisht më 31.12.2012
I. Investime kapitale	1.176.254.105
Rregullimi i truallit ndërtimorë (shpenzime kapitale)	48.527.870
Ndërtimi i rrugëve, rrugicave dhe rrugëve automobilistike	9.343.682
Ndërtimi i infrastrukturës komunale	38.476.787
Akse për varrezat Kamnik	707.401
Ndërtimi i objekteve komerciale	223.182.166
Ndërtimi i garazhit në kate – DAME GRUEV	80.017.510
Ndërtimi i garazhit në kate – MHV JASMIN	141.015.389
Mbikëqyrja e ndërtimit të DAME GRUEV	364.334
Mbikëqyrja e ndërtimit të MHV JASMIN	1.784.933
Projekte për efikasitet energjetik	3.483.360
Marrja e masave për efikasitet energjetik në objektet që janë nën kompetenca të Qytetit të Shkupit	3.483.360
Ndërtimi i ndriçimit publik	28.390.568
Ndërtimi i ndriçimit publik	13.197.335
Revizion i projekteve për ndriçim publik	553.580
Rikonstruksion i ndriçimit publik në ÇARSHINË E VJETËR TË SHKUPIT	14.639.653
Ndërtimi dhe rikonstruksion i rrugëve dhe rrugicave	343.731.938
Përgatitja e projekteve duke përfshirë dizajnin e rrugëve, rrugicave dhe rrugëve automobilistike	33.210.703
Rikonstruksion i bul. Ushtria maqedonase	5.005.470
Rikonstruksion i bul. Jane Sandanski	22.414.901
Rikonstruksion i trotuareve	10.053.932
Rikonstruksion i bul. Ilinden faza e II (dhe faza e III për vitin 2013)	525.810
Rikonstruksion i bul. Shën Kliment Ohridski faza II	20.426.114
Rikonstruksion i qarkores Shën Pjetri dhe Pavle	19.135.603
Rikonstruksion i rr. Mitropolit T. GOLOGANOV deri te ALUMINA	35.302.024
Rikonstruksion i rr. Samoilova	34.098.687
Rikonstruksion i rr. Kozle faza e II	17.125.819
Rikonstruksion i rr. Lazo Tërrovski dhe Brigada e 2 Maqedonase	405.087
Sanim i Juznomoravski brigadi	2.240.106
Rikonstruksion dhe sanim i rr. Radishanska, faza e parë	9.805.905
Rikonstruksion i rr. Bllagoja Stefkovski faza I dhe II (dhe kanalizimi atmosferik)	1.063.660
Rikonstruksion dhe pagesa e TVSH për rikonstruksion të rr. Boris Trajkovski (Prvomajska)	26.105.105
Qarkorja në rr. Boca Ivanova	5.221.362
Ndërtimi i urës në Saraj	49.120.582
Rikonstruksion i urave (konstruksion, rrugë automobilistike, trotuare, gardhe dhe ndriçimi)	20.586.406
Mbikëqyrja e ndërtimit	9.996.960
Eksproprijim të truallit për ndërtim të rrugëve	20.998.586
Kompensime për pronë të marrë për ndërtim të rrugëve	889.120
Ndërtimi i hapësirës për parkim	1.637.403
Ndërtimi i parkingut tek ZOO – obligime	997.442
Ndërtimi i parkingut Matka (Gropa e ariut)	639.961
Ndërtimi i sinjalizimit të komunikacionit	8.491.756
Furnizimi i pajisjeve të semaforëve	2.530.905
Përgatitja e projekteve dhe revizioneve të komunikacionit	5.960.852





Qarkorja në Kishën Shën Pjetri dhe Pavle



Ndërtimi i sistemeve për furnizim me ujë	9.651.311
Ndërtimi i kapaciteteve për furnizim me ujë	8.268.562
Ndërtimi i kapaciteteve ujë sjellëse – tubacion për presion në rr. Salvador Alende	1.382.749
Ndërtimi i sistemeve për mënjanim dhe pastrim të ujërave të zeza	51.545.422
Përgatitja e projekteve për stacione të pastrimit dhe kolektorët	3.132.900
Ndërtimi i kanalizimit atmosferik në KOZLE	1.735.989
Ndërtimi i kanalizimit atmosferik në rr. Radovan Kovačević – bashkëpunim me komunën	2.365.218
Ndërtimi i kanalizimit fekal – TUMBA MAXHARI	5.000.000
Ndërtimi i kanalizimit fekal në fsh. Lubancë	9.990.218
Ndërtimi i stacioneve të pastrimit (VB Bajram Shabani) faza e II	11.150.102
Ndërtimi i stacioneve të pastrimit dhe kolektorëve – Drislla (kolektor) faza 3	12.789.802
Ndërtimi i kanalizimit fekal në bul. KAÇKM	436.600
Ndërtimi i kanalizimit fekal në fsh. Luboten	4.944.593
Pastërtia publike – shpenzime kapitale	935.693
Ndërtimi i objekteve të tjera – xhepa për kontejnerë	935.693
Shërbime të tjera komunale – shpenzime kapitale	59.348.243
Përgatitja e projekteve për objektet banesore – fasadat	1.359.900
Rikonstruksion i objekteve banesore – fasada	53.884.980
Ndërtimi – gërmimi i puseve për ujë teknologjike	1.731.107
Ndërtimi i Plazhit të qytetit	1.926.421
Mbikëqyrja e rikonstruksionit të fasadave	445.835
Parqe dhe gjelbërime - shpenzime kapitale	57.310.397
Përpilimi i 2 kopjeve të skulpturës së VENERA PUDIKA	819.803
Përgatitja e projekteve duke i përfshirë dizajnin dhe objektet tjera	345.740
Projektimi i ndriçimit dhe zërimit në shpellën Vrello në Kanionin Matka	566.400
Rikonstruksioni dhe ngritja e gjelbërimit publik në rrugët magjistrale dhe në parqet	53.498.397
Rikonstruksion i shpellës Vrello tek Kanioni Matka	758.237
Pyllëzimi – ndarja e fidanëve për qytetarët / institucionet/VB	1.321.820
Pajisjet urbane – shpenzime kapitale	14.781.133
Çezma në kejin e I. Vardar	2.230.520
Blerja e tezgave në shesh	5.924.474
Blerja e pajisjeve tjera – ULËSEVE	2.232.000
Blerja e pajisjeve tjera – shtylla për mbrojtje të gjelbërimit	1.045.008
Blerja e pajisjeve tjera – kontejnerë të telit për ambalazh PET	3.349.131
Manifestime kulturore dhe krijimtari - (shpenzime kapitale)	10.809.750
IP Muzeu i Qytetit të Shkupit	
Projekti: Rinovimi i postamentit permanent të muzeve në Muzeun e Çarshisë së vjetër të Shkupit	2.362.920
IP Qendra kulturore informative	
Rikonstruksion i pjesës hyrëse të objektit	600.000
IP Qendra kulturore rinore	
Mbikëqyrja për realizimin e projektit për rikonstruksion të objektit	362.865
IP Salla Universale	
Projekti: Rikonstruksion i nyjave sanitare	316.203
IP Biblioteka e qytetit Vëllezërit Milladinov	
Formimi i shtëpisë përkujtimore të Vëllezërve Milladinov	197.000
Rikonstruksion i çatisë së Bibliotekës	2.655.000

IP Kopshti zoologjik	
Habitate për elefantin dhe gjirafën	4.064.020
IP Shtëpia e kulturës Koço Racin	
Projekti: Rinovimi i salloneve të vogël dhe të madh dhe të hapësirës së magazinës	251.742
Sport dhe rekreacion (shpenzime kapitale)	2.028.227
Ndërtimi i korsive për patina, biçikleta dhe trim korsi në urën për këmbësorë	1.446.363
Blerja e pajisjeve të tjera – furnizimi i biçikletave për huazim	581.864
Arsimi i mesëm shpenzime kapitale	18.769.859
Projektimi i godinave të reja shkollore dhe sallave të edukatës fizike; ko financim me MASH	2.788.605
Rikonstruksion të godinave shkollore dhe sallave të edukatës fizike	15.981.254
Mbrojtja e ambientit jetësor dhe të natyrës (shpenzime kapitale)	31.744.106
Ndërtim të objekteve të tjera – Kopshti botanik	4.489.455
Shënim i kufijve në lokalitetin Gazi Baba – faza e dytë	1.302.956
Shënim i kufijve në lokalitetin Vodno – faza e dytë	2.945.000
Ndërtimi i objekteve të tjera – rregullimi i Gazi Baba	983.890
Ndërtimi i objekteve të tjera – rregullimi i Vodnos	999.150
Plani i posaçëm për mbrojtje të Vodnos	3.997.500
Zëvendësimi i pllakave prej azbesti – çimentoje tek SHMQSH	17.026.155
Shtëpi të pleqve (Programi për mbrojtje sociale) – shpenzime kapitale	23.600
Ndërtimi i ashensorit dhe platformës për persona me nevoja të posaçme në shkollën e mesme Arsenij Jovkov.	23.600
Mbrojtja zjarrfikëse (shpenzime kapitale)	2.026.482
Repetitor, radio lidhje, sistem i kumtesave	1.192.495
Rikonstruksion i objekteve afariste (zëvendësimi i dyerve të garazheve në qendrën Autokomanda)	833.987
Administrata e qytetit – shpenzime kapitale	259.834.825
Blerja e pajisjeve dhe makinave	6.456.489
Rikonstruksion dhe projektim i objekteve afariste	1.371.370
Blerja e mobileve të kancelarisë	297.561
Aksione dhe kapitali tjetër (INVESTIMET THEMELUESE)	784.125
Blerja e automjeteve	6.443.184
Softuer kompjuterik	14.189.777
Ndërtimi dhe mbikëqyrja e Shtëpisë së Qytetit	230.292.319



Bulevardi i rikonstruktuar Jane Sandanski

	Realizuar përfundimisht më 31.12.2012
II. Programi për mirëmbajtje të objekteve komunale dhe infrastrukture	864.558.871
Planifikimi urbanistik	27.643.621
Rregullimi i truallit ndërtimorë	20.936.760
Mirëmbajtja e pajisjeve urbane	1.022.342
Ndriçimi publik	94.283.792
Pastërtia publike	14.061.817
Transporti publik i udhëtarëve	201.010.826
Mirëmbajtja e rrugëve dhe rrugicave lokale	274.321.508
Pastërtia publike	15.143.314
Shërbime të tjera komunale	108.154.892
Mirëmbajtja e hapësirës për parkim	107.980.000



Kopshti botanik



Ura e re në Saraj

**Realizuar përfundimisht më
31.12.2012**

III. Shpenzime për administratën dhe Këshillin e Qytetit të Shkupit

336.197.915

**Realizuar përfundimisht më
31.12.2012**

IV. Programi për realizim të kompetencave me interes publik

249.576.619

Përkrahja e zhvillimit ekonomik lokal

11.252.402

Nxitja e zhvillimit të turizmit

3.219.292

Pagat për të punësuarit dhe kompensimet për këshillat drejtuese – institucionet nga fusha e kulturës nën kompetenca të Qytetit të Shkupit,

12.141.580

Manifestime kulturore dhe krijimtari

53.816.255

Sport dhe rekreacion

39.094.000

Arsimi i mesëm

85.569.070

Mbrojtja e ambientit jetësorë dhe të natyrës

2.640.928

Mbrojtja shëndetësore



1.355.000

Shtëpitë për personat e moshuar (Programi për mbrojtje sociale)

7.323.263

Mbrojtja zjarrfikëse (shpenzime rrjedhëse)

33.164.830



Raport vjetor financiar
Qyteti i Shkupit, viti 2012

Prill, 2013

Shkollat e mesme „Georgi Dimitrov“ dhe „Zdravko Cvetkovski“ nga fillimi i vitit do të ngrohen me gaz. Gazifikimi i shkollave të mesme është projekt me realizimin e të cilit Qyteti i Shkupit kontribuoi për një ambient më të pastër jetësor, gjë për të cilën do të zëvendësohet përdorimi i karburantit të lëngshëm (vaj për amvisëritë, mazut) me gaz natyror, do të eliminohet emisioni i dyoksidit sulfurik dhe blozës, do të ketë zvogëlim të madh të oksidit të azotit dhe zvogëlim të ndjeshëm të dyoksidit të karbonit.

- Në fillimin e semestrit të dytë të vitit shkollor 2012/2013 do të vëmë në përdorim kazanin me gaz në SHMQSH „Georgi Dimitrov“, pjesë e projektit për gazifikimin



SHKOLLAT E MESME „GEORGI DIMITROV“ DHE „ZDRAVKO CVETKOVSKI“ FILLUAN TË NGROHEN ME GAZ

e shkollave të mesme me vlerë prej 6.490.000 denarë. Në këtë projekt hyjnë edhe gazifikimi i SHMQSH „Zdravko Cvetkovski“. Deri tani për ngrohjen e shkollave shpenzohej rreth 4 milion denarë. Pas vendosjes së gazifikimit pritet që kursimi të jetë nga 45 deri në 50 për qind, kurse kthim të investimit do të kemi për një periudhë nga 2 deri në 3 vjet. Gjatë këtij viti planifikojmë të përfshijmë në ngrohjen me gaz edhe SHMQSH „Arseni Jovkov“ dhe SHMQSH „Zef Lush Marku“. Qyteti i Shkupit gjatë 4 viteve të kaluara rinovoi objektet në të gjitha 21 shkollat e mesme. Sipas prioritetit të shkollave u krye rikonstruksioni i dysHEMEVE, mureve, zëvendësimi i zdrukthëtarisë, nyjave sanitare dhe rikonstruksioni i plotë i instalimit elektrik – theksoi kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, në lëshimin në përdorim të pompës së gazit në „Georgi Dimitrov“.



GJIMNAZISTËT E „ZEF LUSH MARKU“ U BËNË ME SALLË TË RE SPORTIVE

Në oborrin e shkollës së mesme „Zef Lush Marku“ në fillim të vitit u ndërtua sallë e re sportive. Objekti është me sipërfaqe 1 300 metra katror, disponon me tribunë me kapacitet prej 400 ndenjësesh, dhomë zhveshjeje, kabina për dush, nyja sanitare, ambiente për akomodimin e rekuizitave sportive, si dhe ambiente të veçanta për mësuesit e lëndës sport dhe aktivitete sportive. Për ndërtimin e kësaj salle Qeveria e Republikës së Maqedonisë shpenzoi rreth 40 milion denarë.

- Ndërtimi i kësaj salle është rezultat i bashkëpunimit të Qytetit të Shkupit, me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, e cila po realizon pa ndërprerje dhe me sukses projektin për ndërtimin e 145 sallave sportive shkollore nëpër Maqedoni.



Qyteti i Shkupit, për lidhjen e sallës sportive me rrjetin e ngrohjes, ujësjellësit dhe kanalizimit ka ndarë rreth 3 milion denarë. Qëllimi është që nxënësve t'u mundësohen kushte më të mira për sport dhe jetë më

me kualitet – theksoi kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, në hapjen zyrtare të sallës sportive në SHMQSH „Zef Lush Marku“.

SHKOLLË E RE E MESME DO TË NDËRTOHET NË SARAJ



Në komunën e Sarajit së shpejti do të fillojë të ndërtohet shkollë e re e mesme. Godina do të jetë me sipërfaqe të përgjithshme 2 020 metra katror dhe do të ketë kat përdhes, kat, ambiente podrumi dhe sistem për ngrohje.

Në objektin e shkollës do të mbahet mësim me kualitet në gjuhën shqipe për 600 nxënës, të cilët do të mësojnë në shumë degë: mjekësi, ekonomi, juridik, dhe nëse ka interesim do të vendoset edhe dega e gjimnazit.

Paratë për ndërtimin e shkollës së re të mesme janë siguruar nga Ministria e arsimit dhe shkencës, kurse mjetet për mbulimin e shpenzimeve komunale do të ndahen nga buxheti i Qytetit të Shkupit.



uniforma verore. Brigada për mbrojtjen kundër zjarrit e Qytetit të Shkupit në vitin 2010 mori edhe 3 automjete të reja zjarrfikëse të dhuruara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, kurse në vitin 2011 mori tre automjete të reja zjarrfikëse për shuarjen e zjarreve në ambient urban. Një automjet zjarrfikës është blerë nga Qyteti i Shkupit, kurse dy automjetet e tjera janë donacion i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Brigada u kompletua edhe

MIRËNJOHJE DHE SHPËRBLIM PËR ZJARRFIKËSIT E SHKUPIT

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, më 18 janar, në stacionin e zjarrfikësve në Autokomandë u takua me zjarrfikësit, të cilët më 15 janar morën pjesë në shuarjen e zjarrit të madh në selinë e „Postat maqedonase“, në shenjë mirënjohjeje për aksionin e tyre në kohë dhe sakrifikues.

- Dua t'ju falënderoj për punën e përfunduar mirë dhe për intervenimin Tuaj në kohë të shpejtë dhe me të cilin penguat dëm më të madh dhe zgjerimin e zjarrit në objektet përreth. Ky ishte një nga zjarret më të mëdha në qytetin tonë në 20 vitet e fundit, kurse Ju rrezikoni jetën Tuaj në luftën me stuhinë e zjarrit. Pikërisht për këtë përkushtim, çdo zjarrfikës që mori pjesë në aksionin për shuarjen do të marrë shpërblim prej 30 për qind të pagës së vet – tha kryetari Trajanovski në takimin me zjarrfikësit.

Trajanovski shtoi se Qyteti i Shkupit në 4 vitet e fundit investon në kontinuitet në pajisjen e Brigadës për mbrojtjen kundër zjarrit të Qytetit të Shkupit, dhe kjo do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

- Blemë dy barka shpëtuese me motor, kamera termike, dy automjete terreni, kapele mbrojtëse zjarrfikëse dhe doreza sipas standardeve evropiane dhe

me kuadër të ri, 25 zjarrfikës ndoqën dhe përfunduan trajnimin modular për profesionin e zjarrfikësit, që u mbajt në ambientet e SHMQSH „Marija Kyri Sklodovska – theksoi kryetari Trajanovski.

Vetëm vitin e kaluar zjarrfikësit e Shkupit intervenuan në më shumë se 1 800 zjarre.



NDIHMË PËR KOMUNAT E GODITURA NGJA PËRMBYTJET

Qyteti i Shkupit dhe ndërmarrjet publike të qytetit u përfshinë në mënyrë aktive në pastrimin e dëmeve nga përmbytjet që muajin e kaluar goditën pjesën lindore të vendit tonë dhe ofruan

ndihmë për komunat e goditura. Një cisternë e NP „Ujësjellës dha kanalizim“ dërgoi ujë të pijshëm në komunën e Shtipit ku për shkak të përmbytjeve u pengua procesi i rregullt me furnizimin

me ujë të pijshëm.

Në komunën Sveti Nikole u dërgua një cisternë nën presion për pastrimin e pusetave.

Vandalizëm në Vodno

U VODHËN AKUMULATORËT E LLAMBAVE NDRIÇUESE TË VEND-PANORAMAVE

Autorë të panjohur në fillim të muajit kanë kryer vjedhje të tetë akumulatoreve të llambave ndriçuese me energji diellore që ndriçojnë vend-panoramën e parë në park-pyllin „Vodno“ dhe gjashtë akumulatore të llambave ndriçuese me energji diellore të vend-panoramës së dytë.

Llambat ndriçuese që ndriçojnë këta dy vend-panorama janë pronësi e Qytetit të

Shkupit, kurse vlera e akumulatoreve është 280 000 denarë.

Qyteti i Shkupit vjedhjen e kryer e denoncoi në polici e cila është në kërkim të keqbërësve.

Qyteti i Shkupit apelon deri te qytetarët të ruajnë pajisjet e vendosura urbane dhe sipërfaqet e gjelbra, si dhe të respektojnë rregullin komunal.



U NDANË 1 500 FIDANË FALAS

Qyteti i Shkupit në aksionin tradicional pranveror për ndarjen e fidanëve bashkësive urbane dhe vendore të interesuara, këshilla banesorë dhe institucioneve arsimore u ndau 1 500 drurë gjetherënës dhe halor.

Këshillave banesorë dhe institucioneve arsimore të cilëve iu pranuan kërkesat, iu ndanë më së shumti 10, kurse bashkësive vendore nga 15 fidanë.

Aksioni i Qytetit të Shkupit për ndarjen e fidanëve organizohet tashmë gjashtë vjet në dy, në pranverë dhe vjeshtë. Qëllimi i këtij aksioni është të rriten sipërfaqet e gjelbra dhe të ngrihet vetëdija publike për rëndësinë e mirëmbajtjes së gjelbërimit ekzistues.

Në kopshtin zoologjik

EKO-ZBAVITJE E MADHE PËR DITËN E PRANVERËS



Me eko-zbavitjen e madhe, që u mbajt në Kopshtin zoologjik, Qyteti i Shkupit festoi Ditën e pranverës dhe ekologjisë,



21 mars. Në këtë manifestim tradicional morën pjesë një numër i madh nxënësish nga shkollat fillore dhe të mesme të Shkupit, të cilët në Kopshtin zoologjik mbollën fidanë, dëgjuan ligjërata për ruajtjen e ambientit jetësor dhe biodiversitetit dhe ndanë mesazhe ekologjike për ambient jetësor më të shëndetshëm dhe më të pastër.

Sekretarja e Qytetit të Shkupit, Gordana Klinçarova, ndau mirënjohje për 28 nxënës të shkollave fillore për pjesëmarrjen e tyre aktive dhe realizimin e suksesshëm të projektit „Mblidh PET që të marrësh pesë (5)“.

Zbavitjen me rastin e Ditës së pranverës, me shfaqjet e tyre e pasuruan fëmijët e Qendrës kulturore të fëmijëve „Karposh“ dhe Orkestra e qytetit.

KONKURS PËR KONTRIBUTIN MË TË MADH PËR RUAJTJEN E AMBIENTIT JETËSOR

Në suazat e manifestimit tradicional „Ditë të pranverës – Ditë të ekologjisë“ Qyteti i Shkupit shpalli konkurs publik për zgjedhjen e kompanisë më ekologjike, kontributit më të madh në fushën e ruajtjes së ambientit jetësor, oborrit të shtëpisë të rregulluar më mirë, ndërtesës dhe objektit ekonomik dhe hartimit dhe vizatimit më të mirë me temë nga ekologjia për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme. Qëllimi i konkursit është që të promovohet dhe popullarizohet kujdesi për ambientin jetësor dhe natyrën.

Sipas kushteve të konkursit publik, Qyteti i Shkupit do të zgjedhë:

1. Kompania më ekologjike (firma me zbatimin e suksesshëm të standardeve ISO 14001 dhe kontribut për ruajtjen e ambientit jetësor);
2. Kontributi më i madh në fushën e mbrojtjes së ambientit jetësor (persona juridikë dhe/ose fizikë të cilët me aktivitetin dhe përpjekjet e tyre kanë bërë më shumë në ruajtjen dhe përmirësimin e ambientit jetësor në qytetin e Shkupit, në drejtim të ruajtjes së medimeve dhe fushës së ambientit jetësor, zvogëlimi i shfrytëzimit të burimeve të jo ripërtëritëse të energjisë etj.);
3. Oborri i rregulluar më mirë (oborr i objektit për strehim individual, strehim kolektiv dhe institucion, firmë dhe objekt ekonomik);
4. Hartimi më i mirë me temën nga ekologjia (për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme);
5. Vizatimi më i mirë me temën nga ekologjia (për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme).

Fletëparaqitjet për qytetarët e interesuar, organizatat joqeveritare, institucionet publike, ndërmarrjet publike dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë të dorëzohen nëpërmjet postës në adresën: Qyteti i Shkupit-Spektori për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës, bul. „Ilinden“ nr. 82, ose në Arkivin e Qytetit, si dhe në telefon 02/3297-273 dhe 3297-302.

Bashkëpunim ndërkombëtar

KRYETARI I QYTETIT TË SHKUPIT KOCE TRAJANOVSKI U TAKUA ME KRYEBASHKIAKUN E LESKOVACIT



Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, më 18 janar pranoi në takim delegacionin e Komunës së Leskovacit, Republika e Serbisë, të udhëhequr nga kryebashkiaku i Leskovacit, Goran Cvetanoviq dhe zëvendësi i tij, Goran Vukadinoviq.

Në takim u bisedua për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe Leskovacit në sferën e zhvillimit ekonomik lokal, kulturës, urbanizmit, sportit, mbrojtjes sociale dhe arsimit.

TAKIM ME ZËVENDËS-KRYEBASHKIAKUN E BUDAPESTIT

Më 1 mars, kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski u takua me zëvendës-kryebashkiakun e qytetit të Budapestit, Ishtvan Gjorgj. Në takim morën pjesë edhe Patrik Borosh nga Drejtoria për marrëdhënie ndërkombëtare e Budapestit, Laslo Tamash, anëtar i komisionit ekonomik, H.E. dr. Jozhef Bence, ambasador i Hungarisë në Republikën e Maqedonisë, Shandor Matjush, sekretar i dytë i ambasadës dhe dr. Atila Pinter, këshilltar, zëvendës i ambasadorit të Hungarisë.

- I njoha mysafirët tanë me projektet të cilat i realizoi Qyteti i Shkupit, por edhe me ato që janë në fazën përgatitore dhe së bashku diskutuam për mundësinë e bashkëpunimit të ndërsjellët në shumë fusha siç është kultura, gazifikimi, komunikacioni, arsimi, sporti, por edhe për iniciativën për vëllazërimin e komunave të Shkupit me



disa komuna të Budapestit. Ky është vetëm fillimi i bashkëpunimit tonë të përbashkët – theksoi kryetari Trajanovski.

Zoti Trajanovski falënderoi anëtarët e delegacionit hungarez për përkrahjen e madhe që ka Republika e Maqedonisë nga Republika e Hungarisë në proceset e integrimit të saj evropian.

- Këtu në Shkup, me të vërtetë mrekullohesh kur shikon ekspansionin arkitektonik të qytetit. Bashkëpunimi

i shkëlqyeshëm ndërmjet dy shteteve është me të vërtetë një bazë e mirë për bashkëpunimin tonë ndërkombëtar në të ardhmen. Eksperiencat ekzistojnë në të dyja anët, dhe sinjerisht shpresoj se bashkëpunimi ynë konkret do të fillojë me shkëmbimin kulturor, dhe pastaj do të thellohet edhe në fusha të tjera – tha zëvendës-kryebashkiaku i Budapestit, Ishtvan Gjorgj.

U HAP EKSPOZITA E PËRHERSHME NË MUZEUN E ÇARSHISË SË VJETËR

Më 22 janar u hap për publikun ekspozita muzeore me eksponate të zanateve të vjetra të Shkupit, e rregulluar në Muzeun e Çarshisë së vjetër të Shkupit, në Suli-an. Ambienti për ekspozitën muzeore janë rinovuar dhe adaptuar në vitin 2011 dhe në vitin 2012, kurse Qyteti i Shkupit për këtë qëllim nga Buxheti ndau 3,4 milion denarë.

- Kjo është dëshmi për përpjekjet e Qytetit të Shkupit për zhvillimin e segmenteve nga kultura jonë: rinovimi dhe modernizimi i institucioneve kulturore të qyteteve, promovimi i kulturës në Çarshinë e vjetër të Shkupit dhe gjithsesi kontributi për zhvillimin e turizmit kulturor, që është në përputhje me Strategjinë për zhvillimin e kulturës së Qytetit të Shkupit në periudhën 2012-2015 – theksoi kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, në hapjen e ekspozitës.

Ekspozita muzeore përbëhet nga



shumë fusha:

Pjesa arkeologjike prezanton sendet nga hulumtimet arkeologjike në Çarshi dhe Kalanë e Shkupit në kontinuitet nga periudha e osmanlinjve. Nëpërmjet monedhave dhe sendeve prej qeramike krijohet një pamje për jetën e Çarshisë dhe përbën për tregtinë e shumëllojshme në ndërthurje kulturore të këtij ambienti.

Pjesa historike, nëpërmjet historisë së treguar të bregut të majtë të lumit Vardar nga shek. i 11-të e këtij, nëpërmjet fotografive të ekspozuara, hartave dhe planeve, treguan themelimin, zhvillimin dhe

jetën e Çarshisë së vjetër të Shkupit, si dhe historinë e monumenteve të rëndësishme kulturore-historike në Çarshi.

Pjesa etnologjike prezanton jetën në Çarshi nëpërmjet profesioneve më dominuese: artizanatit, tregtisë dhe hotelerisë të cilat ekzistojnë në një lloj të ndryshuar plotësisht. Në ekspozitë theksi kryesor u vendos në shumë zanate: lëkurëtarë, papuçë-punues, rrobaqepës, argjendarë, kazanxhinj etj.

Ekspozita u pasurua edhe me vepra artistike të inspiruara nga motivet e Çarshisë. Është përfaqësuar edhe gjenerata e parë e artistëve bashkëkohor të arteve figurative maqedonase (Martinovski, Pandilov, Vladimirovski, Koxhoman etj.), si dhe një pjesë e artistëve bashkëkohor të artit figurativ të Maqedonisë (Anastasov, Mazev, Perçinkov etj.).

Hapja e ekspozitës muzeore do të kontribuojë për edukimin më të mirë të të rinjve dhe njihjen me pasurinë kulturore të Qytetit të Shkupit, për edhe në fuqizimin e ofertës turistike të qytetit, sepse ky muze është qendër nëpërmjet së cilës turistët dhe qytetarët do të njohin historinë e pasur të Çarshisë dhe funksionimin e saj nëpër shekuj.



U FESTUA DITËLINDJA ... E QKR-së



Me rastin e 40 vjetorit të krijimit, më 18 janar të këtij viti në Qendrën kulturore rinore u mbajt manifestimi kulturor „DITËLINDJA...“ në qendër të vëmendjes në festimin e këtij jubileu të rëndësishëm ishte hapja e ekspozitës së tre gjeneratave të artistëve të artit figurativ të njërës prej familjeve më të mëdha të artit te ne - Koxhoman, në galerinë e rinovuar plotësisht të QKR-së.

- Në vitin 1963 me iniciativën e artistit francez Robert Filio, filloi kremtimi i ditës në të cilën ka „lindur arti“. Simbolikisht është përcaktuar 18 janari, dhe që atëherë 50 vitet e kaluara nëpër botë organizohen evenimente të shumta me të cilat shënohet kjo ditë. Duke ndjekur evenimentet globale, QKR-ja kremtoi ditën botërore të artit, duke e pasuruar festimin edhe me një jubile, ditëlindjen e saj – katër dekada nga ekzistimi i Qendrës kulturore rinore – Shkup. Evenimenti këtë vit mban titullin simbolik „Ditëlindja...“, dhe përmbledh në vetvete dy ditëlindjet, ofron program, i cili ashtu si edhe dy vitet e kaluara në këtë ditë

„pushtoi“ hapësirën e QKR-së. Dhe çfarë mund të thotë tjetër njeriu në 36 vitet e mia, për plotë 40 vjet të këtij institucioni, vendi ku karrierat e veta i kanë filluar pothuajse të gjithë regjisorët maqedonas, aktorë, shkrimtarë, piktorë, me një fjalë të gjithë ata që janë pjesë e këtij ambienti kulturor-artistik të këtij vendi. Nuk ka rast më të mirë për të festuar ditëlindjen e QKR-së sesa ky me një ekspozitë të pazakonshme të tre gjeneratave të një prej emrave më të mëdhenj të artit tek ne, Koxhoman – tha drejtori i QKR-së, Zlatko Stevkovski.

Në ekspozitë morën pjesë edhe kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, i cili shfrytëzoi mundësinë për të falënderuar drejtorin Zlatko Stevkovski për pamjen komplet të re të Galerisë, në të cilën ashtu siç tha, të gjithë ne kemi nderin të shikojmë vepra të tre gjeneratave të piktorëve nga familja Koxhoman.

- Në këto katër dekada në këtë qendër kulturore janë organizuar mbi 10 000 evenimente artistike, si shfaqje teatrore, lexime letrare, ekspozita pikturë, instalime dhe performansa. Kjo e dhënë flet

edhe për vizitorët e QKR-së në këto 40 vjet, pikërisht për këtë Qyteti i Shkupit ndihmon nga ana financiare në rikonstruksionin e këtij objekti dhe në përmirësimin e kushteve në të cilat punojnë të punësuarit dhe artistët, por edhe ku, çdo ditë vijnë vizitorë të panumërt. Qyteti i Shkupit edhe në të ardhmen do t'i përkrahë projektet dhe aktivitetet programore të këtij institucioni kulturor rinor – theksoi kryetari Trajanovski.

Në galerinë e rinovuar plotësisht në QKR (për herë të parë pas 40 vjetësh), u vendos një ekspozitë e pazakonshme me vepra të tre gjeneratave të piktorëve maqedonas: Koxhoman I, II dhe III. Ekspozita, e cila do të thotë 110 vjet kontinuitet artistik, filloi me themeluesin e shprehjes artistike bashkëkohore në Maqedoni, Vangjel Koxhoman I, nëpërmjet Millosh Koxhoman II, një nga piktorët më të shquar dhe më aktual maqedonas, dhe Vangjel Koxhoman III, artisti, i cili ka para tij me siguri një obligim moral dhe historik për ta vazhduar këtë tregim të suksesshëm të pazakonshëm të artit figurativ.

Në kinemanë „Frosina“, u mbajt një performansë origjinale poetike (PESNILO), në suazat e të cilës morën pjesë shumë poetë të rinj. Në kinemanë „Milenium“ dhe kinemanë „Frosina“ u mbajt maratonë filmike 24 orë. Në skenën e vallëzimit të QKR-së morën pjesë „Protagonist“ nga Gostivari, „Parketi“ nga Manastiri, „D' Daltons“ nga Shkupi, „Conquering Lion“ nga Tetova dhe „Kanda Koxha dhe Nebojsa“ nga Beogradi.



Në parkun e qytetit

U VENDOSËN GJASHTË BUSTE TË PERSONALITETEVE TË SHQUARA TË HISTORISË MAQEDONASE



Qyteti i Shkupit në pjesën e parë të parkut të qytetit vendosi gjashtë buste të personaliteteve të shquara të historisë maqedonase, përkatësisht të Orce Nikollov, Cvetan Dimov, Koço Racin, Kole Nedelkovski, Krste Petkov Misirkov dhe Nikolla Vapcarov. Bustet e këtyre personaliteteve të shquara ekzistojnë edhe në të kaluarën, por ato u shkatërruan dhe u zhvendosën në mesin e viteve 90-të të shekullit të kaluar.

Ashtu siç premtuam para disa muajsh, bustet e këtyre heronjve përsëri u vendosën në Parkun e qytetit. Apeloj deri te qytetarët e Shkupit t'i ruajnë këto buste sepse ato janë shenjë karakteristike e qytetit tonë dhe Parkut të qytetit. Në drejtim të ruajtjes dhe mbrojtjes së tyre, vëmendje më e madhe do t'i



kushtohet edhe nga ana e ndërmarrjes publike „Parqe dhe gjelbërim“ – tha kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, në promovimin e busteve.

Trajko Stamatovski, kryetari i Këshillit të qytetit të Lidhjes së luftëtarëve shprehu falënderimin deri te Qyteti i Shkupit për realizimin e këtij projekti, sepse me këtë i jepet respekt një pjese të personaliteteve më grandioze të historisë sonë.

Bustet janë përgatitur sipas zgjidhjes ideore të skulptorit akademik Bedi Ibrahim dhe Sokol Cfaraku nga Fakulteti i arteve figurative, sipas konkursit publik të shpallur. Vlera e zgjidhjes ideore, derdhja e busteve dhe rikonstruksioni i bazamenteve është rreth 1,3 milion denarë, mjete të siguruar nga Buxheti i Qytetit të Shkupit.



Donacion

5 675 LIBRA NË GJUHËN TURKE PËR BIBLIOTEKËN „VËLLEZËRIT MILADINOV“

Biblioteka e qytetit „Vëllezërit Miladinov“ mori si donacion 5 675 libra në gjuhën turke, si rezultat i bashkëpunimit me Ministrinë e kulturës dhe turizmit të Turqisë dhe Bibliotekës kombëtare në Ankara, Biblioteka e Kuvendit kombëtar të Turqisë, si dhe në përputhje me Marrëveshjen për kulturë të të dy vendeve.

Librat janë me tituj të ndryshëm nga fusha e letërsisë, literaturës për fëmijë, literaturës profesionale, materiale edukative dhe monografi, që kontribuojnë për zhvillimin e

multikulturës në qytetin dhe shtetin tonë, fuqizimin e respektit dhe miqësisë ndërmjet popullit turk dhe maqedonas, si dhe realizimin e mundësisë për hapjen e katit turk në Bibliotekë, ku qytetarët e nacionalitetit turk do të kenë mundësi të huazojnë literaturë në gjuhën e tyre amtare.

Në shenjë mirënjohjeje për donacionin e madh të librave, kryetari të Bibliotekës kombëtare të Turqisë në Ankara, Tunxher Axhar, iu nda pllakat.

"APRILIJADA 2013"

